



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pronuar - Prilijeno Më/Dana 24.11.2014			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
	01-013/1688		



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 7 pika 1,2 dhe 3 dhe neni 10 pika 1.5 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr 04/L-144 neni 20 pika 2,3 dhe 11 të Rregullores nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, neni 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, neni 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 13.11.2014, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJAT PRONAT E PALUAJTSHME TË KOMUNËS,
KOMPANISË "EKO-ENERGJI" SH.P.K. POZHERAN PËR NDËRTIMIN E MINIHIDROCENTRALIT ME
KAPACITET 0.60MW

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë i JEP në shfrytëzim afat gjatë për 20 vite (njëzet vite) Kompanisë "Eko - Energji" SH.P.K. me pronar Islam Dragobuzhda nga Pozherani, parcelat e Komunës :nr 1845-0, 1893-2, 1893-3, 1893-5, 1893-6, 1893-8, 1893-10, 1893-12, 1893-14, 1844-2, 1843-2, 1833-4, 1833-5, 1833-7, 1777-2, 1777-3, 1792-4, 1792-6, 1791-2, 1871-2, 1871-3 dhe 1792-2 me sipërfaqe 15181m² në ZK Binçë dhe pronat/parcelat nr: 1474-2, 1474-4, 1474-5, 1474-8, 1474-10, 1474-12, 1474-14, 1444-2, 1443-2, 1441-4, 1441-5 dhe 1441-8 me sipërfaqe 8135m² në ZK Kabash.

Neni 2

Parcelat kadastrale të sipëreshënuara, që janë objekt i këtij vendimi, i ipen në shfrytëzim afatgjatë pa të drejtën e dhënies me qira, pa të drejtën e nënkontraktimit në persona të tretë, me mundësi të vazhdimit vetëm për destinacionin e përcaktuar më lartë dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera.

Neni 3

Kryetari i Komunës obligohet që të lidh kontratë, me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

Neni 4

Në rast të ndërtimit, kompania duhet të aplikoj për kushte urbanistike dhe procedura administrative për leje ndërtimore në organet kompetente.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit të si dhe zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Neni 6.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.
Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Drejtorisë për Shërbime Publike,
4. Drejtorisë për Urbanizëm dhe
5. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

